

## MASAT PARAMBROJTËSE:

- Mbajeni në vende të sigurta dhe të pa aritëshme nga fëmijët.
- Ruajeni në vende të thata dhe të freskëta, larg ushqimeve, pijeve dhe ushqimeve për blegtorinë.
- Evitoni kontaktet e zgjatura të syve dhe lëkurës me preparatin
- Evitoni marrjen e preparatit me organet e frymëmarrjes gjatë përgatitjes së solucionit dhe gjatë spërkatjes.
- Gjatë përdorimit të tij mos ha e mos pi ujë dhe duhan.
- Gjatë punës përdor paisje mbrojtëse: kominoshe, doreza, maska, syze.
- Në përfundim të punës lani paisjet mbrojtëse, mjetet spërkatëse.
- Pas përfundimit të punës lani duart dhe pjesët e ekspozuara të trupit.
- Bëni shkatërimin e ambalazhit sipas rregullave në fuqi.

## UDHËZIME PËR NDIHMËN E PARË DHE KËSHILLA PËR MJEKUN:

- Në rast kontakti me lëkurën ose mukozat, lahuni me ujë të bollëshëm dhe sapun.
- Në rast thithje të tretësirës spërkatëse me organet e frymëmarrjes, i aksidentuari çohet në një mjedis të ngrohtë dhe të ajrosur.
- Në rast helmimi, kërkoni menjëherë ndihmë në qendrën më të afërt spitalore, duke i treguar mjekut etiketën e këtij produkti.
- Nuk njihet antidot specifik. Mjekimi sipas simptomave.



Data e prodhimit: Printuar në ambalazh  
Afati i ruajtjes: 3 vjet

1 Lit.

# BANJO

PRODUKT PËR MBROJTJEN E BIMËVE



Lënda vepruese: 500 g/lit Fluazinam

Formulimi: Suspension i koncentruar (SC)

Nr. i regjistrimit: 486, date 2.10.2012.

## FUNGICID KONTAKTI ME VEPRIM MBROJTËS, PAK KURATIV DHE SISTEMIK, ME EFEKT TË MIRË RESIDUAL DHE REZISTENCË TË LARTË NDAJ RESHJEVE TË SHIUT



 **MELDI** Sh.p.k

Distributor:  
MELDI Sh.p.k.  
Tiranë - Shqipëri



Aplikant: **ADAMA Agriculture BV**  
Prodhuesi: **ADAMA Makhteshim Ltd**

## Përdorimi:

Përdoret me sukses për kontrollin e kërpudhave të klasës Oomycetes (*Pytophthora spp.*, *Pernospora spp.*, *Plasmospora spp.*, *Pseudoperonospora spp.*), Ascomycetes (*Venturia spp.*), Mitosponic fungi (*Botrytis cinerea*).

**Në pemëtari:** kundër kromës së mollës e të dardhës (*Venturia Inequalis*, *V.Pirina*) dhe Alternaries së mollës (*Alternaria spp.*), me 70-100 ml/100 lit ujë  
Numri i trajtimeve: 3 herë/sezon.

**Në vreshta:** kundër kalbëzimit (*Botrytis cinerea*), me 100-150 ml/100 lit ujë.

- trajtimi i parë në përfundim të lulëzimit;
- trajtimi i dytë para mbylljes së veshulit;
- trajtimi i tretë, fillim i ngjyrosjes ;
- trajtimi i katert 21 dite para vjeljes.

**Në patate:** kundër vrugut (*Phytophthora infestans*), me 300-400 ml/ha, ka një efekt të lartë dhe të pa aritshëm nga produktet e tjera kundër vrugut të gjetes dhe tuberit.  
Trajtimet përsëriten çdo 10-15 ditë.

**Në domate:** kundër vrugut të gjetes, të kokrrës si dhe vrugut të kërcellit (*Pernospora spp.*), me 400-500 ml/ha. Ka efekt shumë të mirë parandalues kundër Botrytis.

**Në qepë, hudhër, sallatë:** kundër vrugut me dozë 400-500 ml/ha.

**Vërejtje për përdorimin:** BANJO mund të përzihet me fungicidet dhe insekticidet e tjera, me përjashtim të atyre me reaksion alkalik. Nuk përzihet me Dodinë.

**Fitotoksiciteti:** Nuk është fitotoksik kur përdoret me dozat dhe në kulturat e rekomanduara.  
Rezultoni të jetë fitotoksik në kultivarët e rushit (*Muskat dei colli*), Riesling Renano, Trebbiano.  
Për këtë arsye para trajtimit, të bëhen prova paraprake.

**Ndikimi në ekosistem:** Nuk është dëmtues ndaj bletëve, peshqve dhe organizmave të tjerë.

**Karenca:** Për rrushin për vere 28 ditë; domate dhe patate 7 ditë; mollë e dardhë 60 ditë.

**Magazinimi:** Ruhet në vende të erta, të freskëta dhe në ambalazh origjinal.